



Prishtinë: 30.09.2011

Kodi i ZRRE-së: V_373_2011

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_637_08_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_637_08_11**;
5. Apelimi i KEK-ut me datë 23.09.2011;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 shtator 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apelimi i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Musë Musaj (shifra e konsumatorit DPR – 120924) nga Prishtina bazuar në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 02.12.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 09.11.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 17.12.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 7518037 dhe ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 39411928.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 232538 i datës 17.12.2008
- Me datë 03.11.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë konstatuar se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ka vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 39411928 si dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 061504 i datës 03.11.2009
- Me datë 03.11.2009 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë regjistruar të dhënat teknike të njehsorit elektrik nr. 39411928 të vendosur nga vet konsumatori si dhe kanë evidentuar se konsumatori nuk prezanton njehsorin e vjetër nr. 7518037.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit nr. 000949 i datës 03.11.2009
- Me datë 11.10.2010 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse si dhe kanë evidentuar se banesa e konsumatorit është e mbyllur.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0554253 i datës 11.10.2010
- Me datë 14.10.2010 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR10HP08742 në vlerë prej 270.88 €.



Provë: Fatura DPR10HP08742 e datës 14.10.2010

- Konsumatori pas kësaj ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK

- Me datë 09.11.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 09.11.2010

- Me datë 02.12.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

- Me datë 25.08.2011 DMK ka lëshuar një vendim duke aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KEK-u që të:

1. Shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR10HP08742 e datës 14.10.2010 në vlerë 270.88 €.

- Me datë 23.09.2011 KEK-u ka apeluar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së.

Provë: Ankesa e KEK-ut drejtuar Bordit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_637_08_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** apelimin e KEK -ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ka vendosur që vendimi i DMK-së: ZRRE/DMK_V_637_08_11 të mbetet në fuqi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar